REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë më 11 tetor 2019
Nr. Ref.:RK 1444/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI147/18

Parashtrues

Arbër Hadri

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit 06/375, të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor të Kuvendit të Kosovës për rekomandimin e kandidatëve për zgjedhjen e Drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Kompleksëve Memoriale të Kosovës, të 22 majit 2018, dhe Vendimit nr. 06-V-151, të Kuvendit të Kosovës për përzgjedhjen e Drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Kompleksëve Memoriale të Kosovës, të 6 qershorit 2018

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar dhe nënshkruar nga Arbër Hadri, me vendbanim në Komunën e Prishtinës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin [06/375] e 22 majit 2018 të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor të Kuvendit të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Komisioni Parlamentar) për rekomandimin e kandidatëve për përzgjedhjen e Drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Agjencia) dhe Vendimin [Nr. 06-V-151] e 6 qershorit 2018 të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kuvendi) për përzgjedhjen e Drejtorit të Agjencisë.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara, përmes të cilave parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] e 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 5 tetor 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 9 tetor 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban.

7. Më 22 tetor 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe, duke u bazuar në nenin 21 [Përfaqësimi] dhe paragrafin 4 të nenit 22 [Procedimi i kërkesave] të Ligjit dhe paragrafin 2 (c) të rregullit 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] e paragrafin 2 të rregullit 33 [Regjistrimi i kërkesës dhe afati i dorëzimit] të Rregullores së punës, i kërkoi atij që të dorëzojë në Gjykatë, autorizimin që dëshmon se përfaqësuesi i cekur në kërkesë, është i autorizuar që të përfaqësoj parashtruesin e kërkesës para Gjykatës, si dhe të dorëzojë Vendimet që i konteston.

8. Në të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi Kryetarin e Kuvendit, Kryetarin e Komisionit Parlamentar dhe Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit për regjistrimin e kërkesës, dhe e informoi Kryetarin e Komisionit Parlamentar se komentet e tyre

lidhur me kërkesën, nëse kanë, mund t'i dorëzojnë me shkrim në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh.

9. Më 30 tetor 2018, Komisioni Parlamentar dorëzoi komente në lidhje me kërkesën e parashtruesit të kërkesës.

10. Më 13 nëntor 2018, Gjykata pranoi nga parashtruesi i kërkesës informatat dhe dokumentet shtesë të kërkuara nga Gjykata, të cilat i kishte dërguar përmes postës më 8 nëntor 2018. Në lidhje me autorizimin e kërkuar nga Gjykata, ai deklaroi se *"[autorizimi i përfaqësuesit juridik do të realizohet me rastin e mbajtjes eventuale të seancës dëgjimore [...]"*.

11. Më 21 dhjetor 2018, Gjykata njoftoi Kryetarin e Kuvendit, Kryetarin e Komisionit Parlamentar dhe Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit për informatat dhe dokumentet shtesë të dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës dhe kërkoi nga Komisioni Parlamentar që nëse kanë komente lidhur me dokumentet dhe pretendimet shtesë të parashtruesit të kërkesës, përfshirë mungesën e pretenduar të mjeteve juridike, t'i paraqesin ato deri më 4 janar 2018. Gjykata nuk pranoi komente nga Komisioni Parlamentar.

12. Më 17 janar 2019, Gjykata i dërgoi parashtruesit të kërkesës komentet e Komisionit Parlamentar në lidhje me kërkesën e tij e të dorëzuara në Gjykatë më 30 tetor 2018.

13. Më 29 janar 2019, Gjykata pranoi nga parashtruesi i kërkesës, përmes postës elektronike, komentet e tij në lidhje me komentet e Komisionit Parlamentar. Më 31 janar 2019, Gjykata pranoi nga parashtruesi i kërkesës edhe një herë të njëjtat komente që ai i kishte paraqitur përmes postës elektronike më 29 janar 2019.

14. Në të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi Kryetarin e Kuvendit, Kryetarin e Komisionit Parlamentar dhe Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit për komentet e parashtruesit të kërkesës të 29 janarit 2018.

15. Më 4 shtator 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

16. Më 24 prill 2018, duke u bazuar në paragrafin 2 të nenit 6 (Procedura për zgjedhjen e Drejtorit të Agjencisë) të Ligjit nr. 04/l-146 për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Agjencinë), Komisioni Parlamentar mori vendim për shpalljen e konkursit për zgjedhjen e Drejtorit të Agjencisë.

17. Më 22 maj 2018, Komisioni Parlamentar zhvilloi intervistat me kandidatët për Drejtor të Agjencisë dhe në të njëjtën ditë, përmes Vendimit [06/375] vendosi t'i paraqes rekomandim Kuvendit për votim të dy kandidatëve në Seancë Plenare të Kuvendit, përkatësisht B. Z. dhe B. M., të cilët ishin vlerësuar me më së shumti pikë nga Komisioni përkatës. Parashtruesi i kërkesës nuk u përfshi në Vendimin [06/375] e propozuar nga Komisioni Parlamentar, pasi ishte vlerësuar si kandidati i tretë me më së shumti pikë për Drejtor të Agjencisë.

18. Më 29 maj 2018, parashtruesi i kërkesës iu drejtua Drejtorisë së Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale të Kuvendit, duke kërkuar dhënien e udhëzimit për ankimim dhe qasje në dokumente publike (në tekstin e mëtejmë: Kërkesa për dhënien e udhëzimit). Parashtruesi i kërkesës kërkoi nga drejtoria përkatëse (i) sqarimin përkitazi me mjetet juridike në dispozicion për të kontestuar procedurën e vlerësimit të kandidatëve nga Komisioni i Kuvendit; dhe (ii) qasjen në dokumentacionin e plotë të Komisionit përkitazi me vlerësimin dhe rekrutimin e kandidatëve për pozitën e Drejtorit të Agjencisë.

19. Më 6 qershor 2018, Kuvendi votoi për Drejtorin e Agjencisë, dhe me votim të fshehtë, me 45 (dyzet e pesë) vota *"për"* nga 85 (tetëdhjetë e pesë) deputetë që morën pjesë në votim, përmes Vendimit [nr. 06-V-151], zgjodhi njërin nga kandidatët e propozuar nga Komisioni Parlamentar, përkatësisht B.Z. në pozitën e Drejtorit të Agjencisë.

20. Më 7 qershor 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Komisionin Parlamentar në lidhje me procedurat e ndjekura gjatë konkursit për përzgjedhjen e Drejtorit të Agjencisë (në tekstin e mëtejmë: Ankesa në lidhje me procedurat e ndjekura). Përmes kësaj ankese parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, theksoi se (i) nuk i është mundësuar qasja në dokumente publike bazuar në kërkesën e 29 majit 2018, sepse, sipas pretendimit, një pjesë e anëtarëve të Komisionit kanë munguar gjatë intervistimit, përkundër faktit që vlerësimi dhe poentimi i tyre figuron në dokumentacionin e vlerësimit të kandidatëve; (ii) përtej faktit që anëtarët e Komisionit nuk kanë qenë prezent gjatë intervistimit, dy prej tyre kanë marrë pjesë në një ceremoni në Komunën e Istogut, së bashku me kandidatin e përzgjedhur, përkatësisht, B. Z., dhe i cili, sipas pretendimit nuk ka qenë fare prezent në intervistë, duke rezultuar kështu jo vetëm në parregullsi serioze në proces të rekrutimit, por edhe në konflikt interesi në mes kandidatit të përzgjedhur dhe anëtarëve të Komisionit; (iii) kandidatët nuk janë njoftuar për rezultatin e vlerësimit dhe janë informuar vetëm përmes shpalljes së rendit të ditës për seancën plenare të Kuvendit të 6 qershorit 2018, duke mos u mundësuar kandidatëve ankesën përkitazi me këtë vlerësim; dhe (iv) këto parregullsi kanë rezultuar në shkelje kushtetuese dhe rrjedhimisht procesi i rekrutimit të kandidatëve për pozitën e Drejtorit të Agjencisë, duhet të anulohet dhe i tërë procesi të përsëritet.

21. Sipas shkresave të lëndës, rezulton se parashtruesi i kërkesës nuk ka marrë përgjigje nga Kuvendi as përkitazi me Kërkesën për dhënien e udhëzimit dhe as Ankesën në lidhje me procedurat e ndjekura.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Vendimi [06-375] i Komisionit Parlamentar dhe Vendimi [nr. 06-V-151] i Kuvendit për përzgjedhjen e Drejtorit të Agjencisë janë nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës.

23. Parashtruesi i kërkesës argumenton pretendimet për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të lartcekura duke pohuar, ndër të tjera, se (i) gjatë intervistimit të kandidatëve për pozitën e Drejtorit të Agjencisë, Komisioni nuk ka qenë në përbërje të plotë, për më tepër që, dy nga anëtarët e këtij Komisionit, A. H. dhe E. H., respektivisht, në të njëjtën kohë kanë qenë prezent në një solemnitet të organizuar në Dubravë në komunën e Istogut; (ii) për më tepër, sipas pretendimit, as kandidati i përzgjedhur nga Komisioni Parlamentar, nuk ka qenë prezent gjatë intervistimit, sepse i njëjti i ishte bashkëngjitur dy deputetëve të lartcekur në solemnitetin në fjalë; (iii) përkundër faktit që dy deputetët e lartcekur nuk ishin prezent, votat dhe vlerësimi i tyre figuron në "*Listën e votimit*", vlerësim ky që sipas parashtruesit të kërkesës, ka ndikuar në rezultatin dhe renditjen përfundimtare të kandidatëve; (iv) përzgjedhja e Komisionit nuk ishte e bazuar në meritokraci, sepse parashtruesi i kërkesës në konkursin paraprak për të njëjtën pozitë ishte vlerësuar me më së shumti pikë, megjithatë procesi kishte dështuar në seancën e Kuvendit të 17 prillit 2018, ndërsa në konkursin e përsëritur, parashtruesi i kërkesës ishte renditur i treti, duke mos u rekomanduar nga Komisioni për seancë plenare të Kuvendit, përkundër dy kandidatëve tjerë, njëri prej të cilit, sipas parashtruesit të kërkesës, nuk i plotëson kriteret e konkursit dhe i mungon përvoja menaxheriale; (v) votimi nga anëtarët e Komisionit është bërë në disa raste vetëm për një kandidat, duke ju dhënë zero poena kandidatëve të tjerë, rrjedhimisht duke abstenuar në mënyrë selektive; (vi) procesi i votimit për kandidatët në Komisionin Parlamentar nuk ishte i hapur; dhe (vii) kandidatët nuk janë njoftuar për përzgjedhjen e tyre apo jo nga Komisioni Parlamentar.

24. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës pretendon se procesi i vlerësimit dhe rekrutimit të kandidatëve në Kuvend *"nuk ka ofruar garanci të mjaftueshme procedurale për të mbrojtur barazinë e kandidatëve gjatë procesit, dhe si i tillë dëmton perceptimin për pavarësi dhe paanshmëri"*. Ai po ashtu ankohet se nuk ka pasur mundësi ankese apo ndonjë mjet juridik në Kuvend, si institucion përgjegjës për rekrutimin e funksionarëve të lartë të institucioneve të pavarura. Si rezultat i kësaj që u tha më lart, ai pretendon shkelje të neneve 24, 31 dhe 54 të Kushtetutës. Në mbështetje të pretendimeve të tij, parashtruesi i kërkesës i referohet Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KI34/17, të 1 qershorit 2017, me parashtruese *Valdete Daka* (në tekstin e mëtejmë: rasti i Gjykatës KI34/17).

25. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se në rrethanat e tij, nuk ka mjet juridik në dispozicion. Parashtruesi i kërkesës thekson se i është drejtuar Kuvendit dy herë, përmes (i) Kërkesës për dhënien e udhëzimit; dhe (ii) Ankesës për procedurat e ndjekura, dhe nuk ka marrë asnjë përgjigje.

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon rrjedhimisht se nuk ekziston mjet juridik në Kuvendin e Kosovës ku mund të ankohet në lidhje me rastin e tij. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës, duke u referuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) dhe Gjykatës, thekson se në kuptim të shterimit të mjeteve juridike, kjo praktikë kërkon vetëm shterimin e atyre mjeteve që "*ekzistojnë, dhe ekzistojnë jo vetëm në teori, por edhe në praktikë – pra të jenë adekuate dhe efektive*". Në mbështetje të argumenteve të tij për lirimin nga detyrimi për shterimin e mjeteve juridike, parashtruesi i kërkesës i referohet rastit të GJEDNJ-së *Selmouni kundër Francës* (Aktgjykim i GJEDNJ-së i 28 korrikut 1999) dhe Aktgjykimeve të

Gjykatës në rastin KI06/10, me parashtrues *Valon Bislimi v. Ministria e Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor dhe Ministrisë së Drejtësisë*, të 30 tetorit 2010 (në tekstin e mëtejmë: rasti i Gjykatës KI06/10); rastin KI99/14 dhe KI100/14, me parashtrues *Shyqyri Syla dhe Laura Pula*, të 3 korrikut 2014 (në tekstin e mëtejmë: rasti i Gjykatës KI99/14 e KI100/14); dhe rastit të Gjykatës KI34/17.

27. Parashtruesi i kërkesës po ashtu kërkon nga Gjykata të mbajë seancën dëgjimore bazuar në rregullin 42 (E drejta në dëgjim dhe heqja dorë) të Rregullores së punës.

28. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që (i) kërkesa e tij të deklarohet e pranueshme; (ii) të konstatohen shkeljet e pretenduara të nenit 24, 31 dhe 45 të Kushtetutës; (iii) të anulohet procesi i rekrutimit dhe përzgjedhjes së Drejtorit të Agjencisë; si dhe (iv) të urdhërohet rekrutimi dhe përzgjedhja e sërishme e Drejtorit të Agjencisë.

Komentet e Komisionit Parlamentar

29. Në komentet e tyre të dorëzuara në Gjykatë, Komisioni Parlamentar sqaroi se (i) ka zhvilluar intervistë me secilin kandidat që i ka plotësuar kushtet e parapara me Ligjin për Agjencinë dhe në bazë të rezultatit të intervistës, ka përgatitur listën e ngushtë prej 2 (dy) kandidatëve për votim në seancë plenare të Kuvendit; (ii) nuk qëndrojnë pretendimet e parashtruesit të kërkesës se procedura për rekrutimin dhe propozimin e Drejtorit të Agjencisë është bërë në kundërshtim me Kushtetutën dhe Ligjin për Agjencinë. Këtyre komenteve, Komisioni Parlamentar gjithashtu i bashkëngjiti dokumentet në vijim: (i) Vendimin për shpalljen e konkursit për Drejtor të Agjencisë; (ii) Listën e nënshkrimeve të kandidatëve që kanë marrë pjesë në intervistë; (iii) Listën e nënshkrimeve të anëtarëve të Komisionit Parlamentar që kanë marrë pjesë në mbledhjen e 22 majit 2018; (iv) Vlerësimin e kandidatëve për Drejtor të Agjencisë; (v) Listën me renditjen e kandidatëve sipas pikëve për Drejtor të Agjencisë; (vi) Procesverbalin e mbledhjes së Komisionit Parlamentar të 22 majit 2018; (vii) Vendimin [06/375] e Komisionit Parlamentar për rekomandimin e kandidatëve për Drejtor të Agjencisë të 22 majit 2018; dhe, (viii) Vendimin [nr. 06.-V-151] e Kuvendit për zgjedhjen e Drejtorit të Agjencisë.

Komentet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me komentet e Komisionit Parlamentar

30. Në lidhje me komentet e Komisionit Parlamentar, parashtruesi i kërkesës thekson se (i) të njëjtat nuk kundër argumentojnë pretendimet e tij përkitazi me parregullsitë e procesit të kontestuar dhe janë *"janë vetëm një prezantim dhe dalje në sipërfaqe e dokumentacionit të procesit të rekrutimit dhe vlerësimit"* e cila është bërë e qasshme, sipas tij, vetëm pas kërkesës së Gjykatës; dhe (ii) vërtetojnë pretendimet e parashtruesit të kërkesës për parregullsi në procesin e vlerësimit dhe rekrutimit përkatës, parregullsi të cilat kanë rezultuar në shkelje të *"barazisë së kandidatëve"* dhe *"të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm"* të garantuara me Kushtetutë. Më tej, parashtruesi i kërkesës, përsëritë pretendimet dhe argumentet e tij të cilat i kishte paraqitur gjithashtu përmes kërkesës fillestare të dorëzuar në Gjykatë.

31. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu përsërit pretendimin e tij se nuk ka pasur mjet juridik në dispozicion ndaj vendimit të kontestuar. Parashtruesi i kërkesës thekson se nga Kuvendi nuk ka marrë përgjigje as në Kërkesën për dhënien e udhëzimit dhe as Ankesën në lidhje me procedurat e ndjekura.

Vlerësimi i Pranueshmërisë së kërkesës

32. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

33. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *[...]*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

34. Gjykata po ashtu i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që parashohin:

> Neni 47
> [Kërkesa individuale]
>
> *"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*
>
> *2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*
>
> Neni 48
> [Saktësimi i kërkesës]
>
> *Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*
>
> Neni 49
> [Afatet]
>
> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. [...]".*

35. Gjykata merr parasysh edhe rregullin 39 (1) (b) [Kriteret e pranueshmërisë], të Rregullores së punës, që specifikon:

Rregulli 39
[Kriteret e pranueshmërisë]

"1. Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar".

36. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata fillimisht thekson se bazuar në paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit, parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar për të paraqitur kërkesë në Gjykatë. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi në kërkesën e tij fillimisht kishte deklaruar se ai përfaqësohet nga një avokat. Pas kërkesës së Gjykatës për dorëzimin e autorizimit përkatës, parashtruesi i kërkesës deklaroi se *"[autorizimi i përfaqësuesit juridik do të realizohet me rastin e mbajtjes eventuale të seancës dëgjimore [...]"*. Duke marrë parasysh që parashtruesi i kërkesës e ka nënshkruar dhe dorëzuar personalisht kërkesën e tij, Gjykata konstaton se ai nuk përfaqësohet nga ndonjë përfaqësues.

37. Gjykata gjithashtu thekson se parashtruesi i kërkesës konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Vendimin [06/375] e 22 majit 2018 të Komisionit Parlamentar për rekomandimin e kandidatëve për përzgjedhjen e Drejtorit dhe Vendimin [Nr. 06-V-151] e 6 qershorit 2018 të Kuvendit për përzgjedhjen e Drejtorit të Agjencisë. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

38. Megjithatë, në vazhdim Gjykata do të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës ka plotësuar kriterin e shterimit të mjeteve juridike të përcaktuara me ligj, siç kërkohet përmes paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafit 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikës (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës. Marrë parasysh kërkesën e parashtruesit të kërkesës për t'u liruar nga detyrimi i shterimit të mjeteve juridike në rrethanat e rastit konkret, Gjykata në vijim do të (i) paraqes parimet e përgjithshme të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës për sa i takon shterimit të mjeteve juridike; dhe (ii) aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.

(i) Parimet e përgjithshme të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës për sa i takon shterimit të mjeteve juridike

39. Gjykata rithekson se paragrafi 7 i nenit 113 të Kushtetutës përcakton detyrimin e shterimit të *"të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj"*. Ky detyrim kushtetues është gjithashtu i përcaktuar me paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit

përmes së cilit kërkohet që të shterohen të *"gjitha mjetet juridike"* dhe, më tutje me pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës, ku veçanërisht theksohet detyrimi për të shteruar paraprakisht të gjitha mjetet *"efektive"* të përcaktuara me ligj.

40. Kriteret e vlerësimit nëse detyrimi për shterimin e të gjitha mjeteve *"efektive"* juridike është përmbushur, janë mirë të përcaktuara në praktikën e GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, sipas nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, Gjykata është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

41. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se koncepti i shterimit dhe/ose detyrimit për shterimin e mjeteve juridike rrjedh dhe bazohet në rregullat *"përgjithësisht të pranuara të së drejtës ndërkombëtare"*. (Shih, ndër të tjera, rastin *Zvicra kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës,* Aktgjykim i 21 marsit 1959 i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë). E njëjta vlen edhe për GJEDNJ-në, e cila sipas nenit 35 (Kushtet e pranueshmërisë) të KEDNJ-së, mund *"të trajtojë çështjen vetëm pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet e brendshme ligjore sipas rregullave përgjithësisht të pranuara të të drejtës ndërkombëtare [...]"*.

42. Qëllimi dhe arsyetimi i detyrimit për të shteruar mjetet juridike ose rregulli i shterimit është t'u ofrojë autoriteteve përkatëse, para së gjithash gjykatave të rregullta, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Ai bazohet në supozimin që pasqyrohet në nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës dhe në nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së, se rendi juridik i Republikës së Kosovës siguron mjet efektiv për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të makinerisë së drejtësisë kushtetuese. (Shih, në këtë kontekst, rastet e GJEDNJ-së: *Selmouni kundër Francës*, cituar më lart, paragrafi 74; *Kudła kundër Polonisë,* Aktgjykim i 26 tetorit 2000, paragrafi 52; dhe, ndër të tjera, shih edhe rastet e Gjykatës: KI07/15, parashtrues *Shefki Zogiani*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 dhjetorit 2016, paragrafi 61; KI30/17, parashtrues *Muharrem Nuredini*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 gushtit 2017, paragrafi 35; KI41/09, parashtrues *Universiteti AAB-RIINVEST Sh.P.K.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 shkurtit 2010, paragrafi 16; dhe KI94/14, parashtrues *Sadat Ademi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 dhjetorit 2014, paragrafi 24).

43. Gjykata në vazhdimësi e respekton parimin e subsidiaritetit, duke konsideruar se të gjithë parashtruesit e kërkesave duhet të shterojnë të gjitha mundësitë procedurale në procedurat para gjykatave të rregullta, me qëllim që të parandalojnë shkeljen e Kushtetutës ose, nëse ka, të korrigjojnë shkeljen e tillë të një të drejte themelore të garantuar me Kushtetutë. Gjykata po ashtu ka pohuar në vazhdimësi se parashtruesit e kërkesës janë përgjegjës kur rastet e tyre përkatëse shpallen të papranueshme nga Gjykata, nëse nuk kanë shfrytëzuar procedurën e rregullt ose nuk kanë raportuar shkelje të Kushtetutës në procedurat e rregullta. (Shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KI139/12, parashtrues *Besnik Asllani*, Vendim për kërkesën për masë të përkohshme dhe Aktvendim për papranueshmëri, i 25 shkurtit 2013, paragrafi 45; KI07/09, parashtrues *Demë Kurbogaj dhe Besnik Kurbogaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 majit 2010, paragrafët 18-19; KI89/15, parashtrues *Fatmir*

Koçi, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 marsit 2016, paragrafi 35; KI24/16, parashtrues *Avdi Haziri*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 nëntorit 2016, paragrafi 39; dhe KI30/17, parashtrues *Muharrem Nuredini*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 gushtit 2017, paragrafët 35-37).

44. Lirimi nga detyrimi për të shteruar mjetet juridike, në nivel të GJEDNJ-së, bëhet vetëm përjashtimisht dhe vetëm në raste specifike me rastin e analizimit të këtij kriteri të pranueshmërisë në dritë të rrethanave faktike, juridike dhe praktike të një rasti konkret. Edhe në nivel të kësaj Gjykate, bazuar në praktikën e GJEDNJ-së, por edhe në harmoni me praktikën e Gjykatave Kushtetuese të vendeve anëtare të Komisionit të Venecias, lirimi nga detyrimi për të shteruar mjetet juridike, mund të bëhet vetëm përjashtimisht. (Shih rastet e Gjykatës në të cilat është aplikuar një përjashtim i tillë: Kl56/09, parashtrues *Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë*, Aktgjykim i 22 dhjetorit 2010, paragrafët 44-55; Kl06/10, parashtrues *Valon Bislimi*, Aktgjykim i 30 tetorit 2010, paragrafët 50-56 dhe paragrafi 60; KI41/12, parashtrues *Gëzim dhe Makfire Kastrati*, Aktgjykim i 25 janarit 2013; paragrafët 64-74; Kl99/14 dhe KI100/14, cituar më lart, paragrafët 47-50; KI55/17, parashtrues *Tonka Berisha*, Aktgjykim i 5 korrikut 2017, paragrafët 53-58; dhe KI34/17, parashtruese *Valdete Daka,* Aktgjykim i 1 qershorit 2017, paragrafët 68-73).

45. Përjashtimet, përkatësisht lirimi nga detyrimi për shterimin e mjeteve juridike, janë të përcaktuara në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së e cila, thekson se rregulli i shterimit, duhet zbatohet me një "*shkallë të fleksibilitetit dhe pa formalizëm të tepruar*", duke pasur parasysh kontekstin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. (Në lidhje me konceptin e "*fleksibilitetit dhe mungesën e formalizmit të tepruar*", shih Udhëzuesin Praktik për Kriteret e Pranueshmërisë të GJEDNJ-së të 30 prillit 2019, I. Bazat Procedurale për Papranueshmëri, A. Mosshterja e mjeteve juridike, 2. Aplikimi i këtij rregulli, A. Fleksibiliteti, faqe 22 dhe, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së *Ringeisen kundër Austrisë*, Aktgjykim i 16 korrikut 1971, paragrafi 89).

46. Në parim, bazuar në praktikën e GJEDNJ-së, detyrimi për të shteruar mjetet juridike, është i kufizuar në përdorimin e atyre mjeteve juridike, (i) ekzistenca e të cilave është "*mjaftueshëm e sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë*", dhe rrjedhimisht të njëjtat, duhet të jenë në gjendje "*të ofrojnë zgjidhje përkitazi me pretendimet e një parashtruesi*" dhe "*të ofrojnë një mundësi të arsyeshme për sukses*"; dhe (ii) të cilat janë në "*dispozicion, të qasshme dhe efektive*", karakteristika këto të cilat duhet të jenë mjaftueshëm të konsoliduara në praktikën gjyqësore të sistemit përkatës juridik. (Shih rastet e GJEDNJ-së: *Selmouni kundër Francës*, cituar më lart, paragrafët 71-81; *Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë*, cituar më lart, shih Seksionin B. lidhur me shterimin e mjeteve juridike të brendshme, paragrafët 55-77; *Demopolous dhe të tjerët kundër Turqisë*, Aktgjykim i 1 marsit 2010, Seksionet: A. Parashtresat para Gjykatës për shterimin e mjeteve të brendshme juridike dhe B. Shterjen e mjeteve juridike vendore, respektivisht, paragrafët 50-129; *Öcalan kundër Turqisë*, Aktgjykim i 12 majit 2005, paragrafët 63-72; dhe *Kleyn dhe të tjerët kundër Holandës*, Aktgjykim i 6 majit 2003, paragrafët 155-162).

47. Megjithatë, dhe përtej këtyre mundësive përjashtimi, në të gjitha rastet dhe në bazë të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, parashtruesi duhet të dëshmojë se "*ai*

ka bërë gjithçka që mund të pritet në mënyrë të arsyeshme nga ai që të shterojë mjetet juridike". (Shih rastin e GJEDNJ-së *D. H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, Aktgjykim i 13 nëntorit 2007 paragrafi 116 dhe referencat e përmendura aty). GJEDNJ potencon se është në interes të parashtruesit të kërkesës që t'i drejtohet gjykatës kompetente për t'i dhënë asaj mundësinë që të ushtrojë të drejtat ekzistuese përmes fuqisë së saj të interpretimit. (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së: *Ciupercescu kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 15 qershorit 2010, paragrafi 169). Kjo me përjashtim të rasteve kur një parashtrues mund të tregojë, duke ofruar praktikën gjyqësore përkatëse ose ndonjë dëshmi tjetër të përshtatshme, se një mjet juridik në dispozicion e të cilin ai nuk e ka shfrytëzuar, do të dështonte. (Shih rastet e GJEDNJ-së: *Kleyn dhe të tjerët kundër Holandës*, cituar më lart, paragrafi 156 dhe referencat e përmendura aty, dhe *Selmouni kundër Francës*, cituar më lart, paragrafët 74-77). Për më tepër, "*dyshimet e thjeshta*" të një parashtruesit rreth joefikasitetit të një mjeti juridik nuk vlejnë si arsye për ta liruar një parashtrues nga detyrimi për shterimin e mjeteve juridike. (Shih, ndër të tjera, rastet e GJENDJ-së; *Milošević kundër Holandës*, Vendim i 19 marsit 2002, paragrafi i fundit të faqes 6; dhe *MPP Golub kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 18 tetorit 2005, paragrafi i fundit i Seksionit C mbi Vlerësimin e Gjykatës).

48. Gjykata gjithashtu thekson se vlerësimi fleksibil i karakteristikave të nevojshme të mjetit juridik, duhet të bëhet duke marrë parasysh rrethanat e secilit rast individual. Në këtë drejtim, GJEDNJ gjithashtu ka përvetësuar konceptin e "*rrethanave të veçanta*", përmes të cilit e bën vlerësimin, nëse ka ndonjë bazë të veçantë që e liron parashtruesin përkatës nga përmbushja e detyrimit të shterjes së mjetit juridik. Në bërjen e këtij vlerësimi, GJEDNJ merr parasysh edhe (i) kontekstin e përgjithshëm ligjor dhe politik; dhe (ii) "*rrethanat e veçanta*" të një parashtruesi. (Për konceptin e "*rrethanave të veçanta*", ndër të tjera, shih rastet e GJEDNJ-së: *Van Oosterijck kundër Belgjikës*, cituar më lart, paragrafët 36-40, dhe referencat përkatëse në të; *Selmouni kundër Francës*, cituar më lart, paragrafët 71-81 dhe referencat përkatëse në të; *Öcalan kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 67; dhe *Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafët 67-68 dhe referencat në të. Më tej, lidhur me shqyrtimin e kontekstit të përgjithshëm ligjor dhe politik, ndër të tjera, shih *Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafët 68-69 dhe referencat në të; dhe *Selmouni kundër Francës,* cituar më lart, paragrafi 77). Në rastet në të cilat rezulton se detyrimi i një parashtruesi për të përdorur një mjet juridik mund të jetë i paarsyeshëm në praktikë dhe do të paraqiste një pengesë joproporcionale për të ushtruar efektivisht të drejtën e tij, GJEDNJ liron parashtruesin nga detyrimi për shterjen e mjeteve juridike. (Shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së: *Veriter kundër Francës*, Aktgjykim i 15 dhjetorit 1997, paragrafi 27; *Gaglione dhe të tjerët kundër Italisë*, Aktgjykim i 21 dhjetorit 2010, paragrafi 22; dhe *M.S. kundër Kroacisë (nr.2)*, Aktgjykim i 19 shkurtit 2015, paragrafët 123-125).

49. Në fund, Gjykata thekson, se duke marrë parasysh parimin e vlerësimit fleksibil të shterimit të mjeteve juridike dhe përshtatjen e këtij vlerësimi "*rrethanave të veçanta*" të secilit rast veç e veç, GJEDNJ ka zhvilluar testin e "*barrës së të provuarit*", proces ky i përcaktuar qartë në praktikën e saj gjyqësore. Sipas kësaj të fundit, në kontekst të GJEDNJ-së, shpërndarja e barrës së të provuarit ndahet midis parashtruesit të kërkesës dhe qeverisë përkatëse që pretendon mosshterimin. (Për një diskutim më të detajuar mbi *shpërndarjen e barrës së*

provës, ndër të tjera, shih rastet e GJEDNJ-së: *Selmouni kundër Francës*, cituar më lart, paragrafi 76 dhe referencat në të; dhe *Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 68 dhe referencat në të). Në parim, pas pretendimeve të parashtruesit përkatës për mungesë të mjetit juridik, pala kundërshtare, përkatësisht shteti përkatës në kontekst të GJEDNJ-së, mban barrën e të provuarit se ekziston një mjet juridik që nuk është përdorur dhe i cili është "*efektiv*", ndërsa, parashtruesit përkatës do të duhet të argumentojnë të kundërtën, përkatësisht se mjeti i referuar është përdorur apo që i njëjti nuk është "*efektiv*" në rrethanat e rastit përkatës. Mbështetja në praktikë përkatëse gjyqësore është relevante në të dyja rastet.

50. Në kontekstin e parimeve të lartcekura, Gjykata, në vijim do të shqyrtojë nëse në rrethanat e rastit konkret, (i) mjeti juridik është përdorur dhe parashtruesi i kërkesës ka "*bërë gjithçka që mund të pritet në mënyrë të arsyeshme nga ai që të shterojë mjetet juridike*"; dhe nëse parashtruesi i kërkesës, bazuar në barrën e të provuarit, ka dëshmuar se (ii) mjeti juridik nuk është "*mjaftueshëm e sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë*"; dhe (iii) mjeti juridik nuk është në "*dispozicion, i qasshëm dhe efektiv*".

(ii) Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret

51. Gjykata fillimisht vëren se parashtruesi i kërkesës i është drejtuar Kuvendit dy herë, herën e parë përmes Kërkesës për dhënien e udhëzimit, ndërsa herën e dytë, përmes së Ankesës në lidhje me procedurat e ndjekura dhe sipas shkresave të lëndës, nuk ka marrë përgjigje asnjëherë nga Kuvendi. Për më tepër, Gjykata gjithashtu vëren se përmes Kërkesës për dhënien e udhëzimit, parashtruesi i kërkesës specifikisht kishte kërkuar sqarime përkitazi me mjetet juridike në dispozicion për të ankimuar Vendimin [06/375] e Komisionit Parlamentar. Sipas shkresave të lëndës, parashtruesi i kërkesës nuk kishte marrë përgjigje. Gjykata për më tepër vëren se Gjykata i kishte dhënë mundësi Kuvendit, përmes shkresës së 21 dhjetorit 2018, të paraqet komentet përkatëse përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës të dorëzuara në Gjykatë, përfshirë mungesën e pretenduar të një mjeti juridik, dhe Kuvendi, edhe pse kishte dorëzuar komente në Gjykatë, nuk kishte adresuar specifikisht çështjen e mjeteve juridike.

52. Megjithatë, Gjykata vëren që në rrethanat e rastit konkret, përtej mundësisë së kontestimit të procedurave përkitazi me përzgjedhjen e Drejtorit të Agjencisë brenda Kuvendit, ligjet e aplikueshme u referohen edhe mjeteve tjera juridike të përcaktuara përmes Ligjit nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (në tekstin e mëtejmë: LKA) dhe Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Këshillin e Pavarur), respektivisht.

53. Gjykata thekson se (i) ndër të tjera, nenet 13 dhe 14 të LKA-së e që ndërlidhen me konfliktin administrativ përcaktojnë mundësinë e inicimit të konfliktit administrativ, duke përfshirë edhe në rastet e heshtjes administrative. (Shih, në këtë kontekst, gjithashtu rastin e GJEDNJ-së *Juričić kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 26 korrikut 2011, në të cilin janë shqyrtuar pretendimet e një kandidateje për gjyqtare të Gjykatës Kushtetuese Kroate. Përderisa GJEDNJ kishte trajtuar pretendimet e saj në raport me vendimin e Gjykatës Kushtetuese

Kroate, rasti gjithashtu reflekton kompetencën e gjykatës përkatëse administrative për të vlerësuar, përkundër kufizimeve, vendimet e Kuvendit Kroat); ndërsa (ii) paragrafi 3 i nenit 3 (Statusi i Agjencisë) të Ligjit për Agjencinë përcakton se *"nëpunësi i Agjencisë ka statusin e shërbyesit civil"*, përderisa neni 6 (Funksionet e Këshillit) të Ligjit për Këshillin e Pavarur, ndër të tjera, përcakton se Këshilli *"shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil"*.

54. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk u referohet këtyre mjeteve juridike si mundësi për të kontestuar Vendimet e kontestuara të Kuvendit. Gjykata gjithashtu vëren se në rrethanat e rastit konkret asnjëra prej këtyre mundësive nuk është përdorur. Gjykata kujton faktin që Kuvendi nuk i është përgjigjur parashtruesit të kërkesës as në Kërkesën për dhënien e udhëzimit dhe as në Ankesën e tij në lidhje me procedurat e ndjekura. Megjithatë, Gjykata vëren se përveç ankesës së paraqitur para Komisionit Parlamentar, parashtruesi i kërkesës, ka pasur mundësi të përdor edhe mjete të tjera juridike për të sfiduar vendimet e kontestuara, duke përfshirë edhe në rast të heshtjes administrative. Në të kundërtën, parashtruesi i kërkesës do të duhet të argumentonte se këto mjete juridike nuk janë (i) *"mjaftueshëm të sigurta jo vetëm në teori, por edhe në praktikë"*; dhe/ose (ii) *"dispozicion, të qasshme dhe efektive"*.

55. Rrjedhimisht, dhe në këtë kontekst, Gjykata duhet të theksoj se mjetet juridike në dispozicion të parashtruesit të kërkesës nuk janë përdorur, dhe se përkundër Kërkesës për dhënien e udhëzimit dhe Ankesës në lidhje me procedurat e ndjekura të dorëzuara në Kuvend, parashtruesi i kërkesës nuk ka *"bërë gjithçka që mund të pritet në mënyrë të arsyeshme nga ai që të shterojë mjetet juridike"*. Siç është cekur më lart përgjatë shtjellimit të parimeve të përgjithshme, bazuar në procesin e barrës së të provuarit, i takon fillimisht parashtruesit të kërkesës që të dëshmoj se (i) ka bërë gjithçka që mund të pritet për t'i shteruar mjetet juridike; (ii) që ka përdorur mjetet juridike në dispozicion; dhe nëse kjo nuk ka ndodhur, atëherë, (iii) të tregojë, duke ofruar praktikën gjyqësore përkatëse ose ndonjë dëshmi tjetër të përshtatshme, se një mjet juridik në dispozicion e të cilin ai nuk e ka shfrytëzuar, do të dështonte. Ky nuk është rasti në rrethanat e rastit konkret.

56. Për më tepër, Gjykata rikujton, ashtu siç ka theksuar edhe vet parashtruesi i kërkesës, se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së por edhe Gjykatës, përcaktojnë që rregulli i shterimit, duhet të zbatohet me një *"shkallë të fleksibilitetit dhe pa formalizëm të tepruar"*. Megjithatë, në zbatimin e këtij parimi, barra e të provuarit është po ashtu e një rëndësie të veçantë. Parashtruesi i kërkesës, duhet të argumentojë se mjetet juridike në dispozicion, nuk janë (i) *"mjaftueshëm të sigurta jo vetëm në teori, por edhe në praktikë"*; dhe/ose (ii) *"dispozicion, të qasshëm dhe efektiv"*.

57. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës nuk argumenton pse në rrethanat e rastit të tij, mjetet juridike të përcaktuara përmes LKA-së, por edhe Ligjit për Këshillin e Pavarur nuk i posedojnë këto karakteristika. (Shih, në këtë kontekst, Aktvendimin për papranueshmëri në rastin KI116/14, parashtrues *Fadil Selmanaj,* të 26 janarit 2015, paragrafët 45-46). Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës nuk i ka ofruar Gjykatës asnjë argument përkitazi me mjetet juridike të lartreferuara dhe as nuk ka

argumentuar pse në rrethanat e rastit tij, të njëjtat nuk janë *"në gjendje të ofrojnë zgjidhje"* ose nuk *"ofrojnë mundësi të arsyeshme për sukses"* përkitazi me pretendimet e tij për shkelje kushtetuese.

58. Gjykata rikujton që në mbështetje të pretendimeve për mungesën e një mjeti juridik në rrethanat e rastit tij, parashtruesi i kërkesës i referohet edhe rastit të GJEDNJ-së *Selmouni kundër Francës*, (cituar më lart) dhe rasteve të Gjykatës KI06/10; KI34/17; dhe KI99/14 e KI100/14.

59. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht vëren se, përveç faktit që parashtruesi i kërkesës ka cekur dhe ka cituar këto vendime, ai nuk ka elaboruar lidhshmërinë e tij, faktike dhe juridike, me rrethanat e rastit konkret. Gjykata thekson që arsyetimet e vendimeve tjera gjyqësore duhet të interpretohen në kontekstin dhe në dritën e rrethanave faktike në të cilat janë nxjerrë. (Shih, ndër të tjera në këtë kontekst, Aktgjykimin në rastin KI48/18 të 4 shkurtit 2019, me parashtrues *Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës* (LDK), paragrafi 275; dhe rastin KI119/17, parashtrues *Gentian Rexhepi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 majit 2019, paragrafi 80).

60. Gjykata megjithatë thekson që rrethanat e rasteve të cilave u referohet parashtruesi i kërkesës, nuk përkojnë me rrethanat e tij. Në rastet e lartcekura, Gjykata kishte vlerësuar se parashtruesit përkatës kishin dëshmuar se (i) nuk kishte mjete juridike në dispozicion, siç është në rastin e Gjykatës KI06/10 (shih rastin KI06/10, të cituar më lart, paragrafët 48-61) ose (ii) mjetet juridike që ishin në dispozicion të parashtrueseve të kërkesës nuk ishin mjaftueshëm efektive për të adresuar pretendimet përkatëse. (Shih rastin e Gjykatës KI34/17, të cituar më lart, paragrafin 73; dhe rastin e Gjykatës KI99/14 dhe KI100/14, të cituar më lart, paragrafin 50).

61. Rrjedhimisht, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk i plotëson kriteret e pranueshmërisë pasi që nuk ka shteruar mjetet juridike siç është përcaktuar në paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafit 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikës (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës, dhe si e tillë, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme.

Kërkesa për mbajtje të seancës dëgjimore

62. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka kërkuar nga Gjykata që të mbajë seancë dëgjimore.

63. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se në bazë të paragrafit 1 të rregullit 42 të Rregullores së punës, *"Vetëm kërkesat e përcaktuara si të pranueshme mund të dëgjohen para Gjykatës, përveç nëse Gjykata, me shumicë votash, vendos ndryshe pas një arsyetimi të mirë"*, ndërsa në bazë të paragrafit 2 të po të njëjtit rregull, *"Gjykata mund të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rast se beson se ajo është e nevojshme për të qartësuar çështje të provave apo ligjit"*.

64. Gjykata thekson se rregulli i lartcekur i Rregullores së punës është i karakterit diskrecional. Për më tepër, Gjykata thekson se, bazuar në rregullin e lartcekur, vetëm rastet të cilat shpallen të pranueshme dhe shqyrtohen meritat përkatëse mund të dëgjohen para Gjykatës përmes seancës dëgjimore. Rregullorja e punës i mundëson Gjykatës që përjashtimisht të bëjë një gjë të tillë edhe në raste kur një kërkesë nuk është e pranueshme, siç është rasti në rrethanat e rastit konkret. Megjithatë, Gjykata rikujton që bazuar në paragrafin 2 të rregullit 42 të Rregullores së punës, ajo mund të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rastet kur ajo beson se është e nevojshme për të qartësuar çështje të provave apo ligjit. Në rrethanat e rastit konkret, ky nuk është rasti sepse Gjykata nuk konsideron se ka ndonjë paqartësi rreth *"provave apo ligjit"* dhe për këtë arsye nuk e sheh të nevojshme mbajtjen e seancës dëgjimore. Dokumentet e përfshira në kërkesë janë të mjaftueshme për të vendosur këtë rast.

65. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit të kërkesës për mbajtje të seancës dëgjimore refuzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, të nenit 47.2 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës, më 4 shtator 2019, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;

III. TË REFUZOJË kërkesën për seancë dëgjimore;

IV. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

V. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Gresa Caka-Nimani

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi